



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DEÇAN
OPSTINA DEÇAN



INFORMATË NGA DREJTORIA PËR ARSIM

Fushëveprimtaria e Drejtorisë

Drejtoria për Arsimit ushtron funksion dhe përgjegjësi në bazë të Ligjit lidhur me organizimin e arsimit për fëmijë dhe të rrituri duke filluar nga niveli: 0,1,2 dhe 3 dhe të rriturëve në Komunë;

Nxitë barazinë dhe mundësinë për të ndjekur arsimin parashkollor, parafillor, fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë në Komunë, në zhvillimin dhe aftësimin e personelit në të gjitha aspektet e tjera të arsimit;

Respekton dhe nxit të drejtat e komuniteteve dhe anëtarëve të tyre

Nxitë bashkëpunimin midis mësuesve, prindërve, nxënësve dhe institucioneve arsimore, familjes dhe komunitetit

Bën regjistrimin e të dhënave personale të nxënësve në një format të miratuar nga MASHT-i;

Bashkëpunon ngusht me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në interes dhe bashkëveprim në mes dy palëve në interes të nxënësve;

Planifikon zhvillimin e arsimit parashkollor fillor dhe të mesëm në Komunë, në konsultim me MASHT-in dhe komunat të tjera;

Në marrëveshje me MASHT-in, miraton rregullat për themelimin, shkrirjen, ndarjen dhe mbylljen e institucioneve arsimore me fonde publike të niveleve 0,1,2 dhe 3 në Komunë;

Rregullon se cilat shkolla i përkasin zonave specifike të mbulimit në komunë;

Bën mirëmbajtjen dhe riparimin e ndërtesave dhe pajisjeve të institucioneve arsimore me fonde publike si, mirëqenien fizike të nxënësve duke përfshirë me ujë të freskët, ambient të shëndetshëm, ambient rrethues nëpër shkolla;

Nxit, në bashkëpunim me MASHT-in, politikën shoqërore dhe objektivat e shëndetit publik nëpërmjet aktiviteteve shkollore dhe jashtëshkollore, duke përfshirë programe për sigurimin në rrugë, fusha dhe shëndetin e nxënësve duke ju shmangur sëmurjeve ngjitëse si dhe aksionit kundër duhanit dhe drogës;

Miratimin e pushimeve lokale të shkollës;

Miratimin e rregullave të shkollës;

Punësimin dhe pagat për mësimdhënës dhe drejtorë të shkollave të komunës;

Shqyrton masat lidhur me ankesat e nxënësve;

Angazhohet për realizimin e arsimit special në konsultim me MASHT-in për nxënës me nevoja të veçanta;

Miraton rregullat për sjelljen dhe disiplinën e nxënësve të shkollave.